REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2691 Prot. Maliq, më 04.05.2026

VENDIM
Nr.59, datë 30.04.2026
"PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BANORËVE TË FSHATIT KOLANEC DHE ORGANIZIMIN E AKTIVITETIT KULTUROR 'FESTA E QERSHIVE"

Në mbështetje të nenit 8, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 25 *"Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese"* dhe nenit 54 *"Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë"* gërma "c", të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, si dhe kërkesës së banorëve të fshatit kolanec, protokolluar pranë Bashkisë Maliq me nr.2063 prot., datë 03.04.2026, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e banorëve të fshatit Kolanec për organizimin e aktivitetit kulturor "Festa e Qershive" për vitin 2026.
2. Të shpallë javën e parë të muajit Qershor si periudhën zyrtare të zhvillimit të *"Festës së Qershive"* në fshatin Kolanec.
3. Ngarkimin e Bashkisë Maliq dhe strukturat e saj për marrjen e masave organizative, bashkërendimin me organizatorët dhe ofrimin e mbështetjes institucionale dhe logjistike, në përputhje me kuadrin ligjor dhe mundësitë buxhetore të miratuara.
4. Drejtoritë përkatëse të Bashkisë Maliq të marrin masat për bashkëpunimin me organizatorët, me qëllim promovimin e vlerave kulturore, bujqësore dhe turistike të zonës.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", indryshuar.

Miratuar me 16 vota
Vota Pro 16
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 04.05.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ